

Irène Némirovsky

ZJARRET E VJESHTËS

Roman

Përktheu nga origjinali frëngjisht

Diana Çuli

Mbi tryezë ishte një tufëz vjollcash të sapokëputura - në një vazo të verdhë me grykën në formë sqepi pate që hapej me një zhurmë të lehtë për të lënë të derdhej uji - si dhe një kripore prej xhami mbi të cilën lexohej: «Kujtim nga Ekspozita Universale. 1900» (Në dymbëdhjetë vjet gërmat ishin zvenitur, vende-vende ishin dhe të palexueshme). Aty pranë, një bukë e madhe e praruar, verë dhe pjata kryesore - një *blanquette*¹ e mrekullueshme viçi, copërat e buta të të cilit fshiheshin ngapak nën salcën e trashë, nën kërpudhat e buta dhe gjithë aromë e nën patatet e pjekura. Asnjë lloj mezeje, sa për të hapur oreksin: ushqimi është gjë serioze. Familja Brën e niste drekën a darkën me gatimin kryesor; jo se i përbuzte të skuqurat, përgatitja e të cilave, me ato rregullat e thjeshta e njëkohësisht të rrepta i afronte me artin klasik, por, ajo që gatuante në atë shtëpi i përkushtohej me të gjitha dijenitë e aftësitë e saj gatimeve me pjekje e me avull. Tek Brënët, me kuzhinën merrej kryesisht vjehrra, zonja e vjetër Pen.

Familja Brën ishte një familje pariziane që jetonte me disa pak të ardhura nga rentat. Adolf Brënit, të cilit i kishte vdekur gruaja, i takonte të ulej në krye të tryezës dhe t'i shërbente çdokujt pjesën e tij. Ishte akoma burrë i pashëm, me ballë të gjerë e me flokët e rënë, me hundën e vogël të kthyer paksa lart, faqembushur dhe me mustaqe të gjata e të kuqërreme, që i përdridhte e i rrotullonte vazhdimisht me gishtërinj, sa majat e tyre gati i hynin në sy. Përballë tij, e vjehrra, rrondokope, shkurtabiqe dhe e fortë qiçër, me kokën e rrethuar me një kurorë flokësh të bardhë, të butë e fëshfëritës si shkumë deti; ajo buzëqeshte, duke nxjerrë në pah ca dhëmbë të përsosur dhe i kthente mbrapsht lëvdatat me një lëvizje të dorës së saj buçkane: («Sa e shijshme... Asnjë herë më parë nuk e keni bërë kaq të mirë, mama... E mrekullueshme, zonja Pen!»)

Atëherë ajo mblidhte buzët me modesti të rreme, si një primadonë që i kalon shoqëruesit të saj lulet që i kanë dhuruar në skenë. Mërmëriste në majë të buzëve: - Eh, po, kësaj radhe kasapi më zgjodhi një copë gjoksi vërtet të mirë.

Në të djathtë të Adolf Brënit uleshin të ftuarit - tre Zhakëlenët - në të majtë nipi i tij, Marsiali dhe e bija, Tereza. Kjo e fundit, me rastin e pesëmbëdhjetë vjetorit që e kishte patur pak ditë më parë, i kishte mbledhur flokët *chignon*²; por kaçurrelat e saj të mëndafshhta nuk i ishin përshtatur ende krehjeve me karfica dhe i dilnin nga të

1. Gatim tipik francez i ngjashëm me frikasenë e viçit, shumë i përhapur në klasën borgjeze.

2. Topuz

gjitha anët, gjë që e mërziste vajzën, megjithë lavdërimet që kushëri Marsiali i pëshpëriste nën zë e i kuq deri në rrëzë të veshëve:

- Sa e lezetshme që jeni bërë, Terezë. Kjo krehja e re e flokëve... duket si një re e artë.

- Vogëlushja ka krejt flokët e mija, - tha zonja Pen, që kishte lindur në Nicë dhe që, në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare e la qytetin për t'u martuar me një tregtar fjongosh e vellosh që banonte në Paris, por që nuk e kishte humbur theksin e origjinës, të butë e plot tingëllima, sikur këndonte. Sytë i kishte shumë të bukur, të zinj, që i lëvrinin gjithë dritë e gëzim. I shoqi e kishte rrënuar; vajza - nëna e Terezës - i vdiq sapo mbushi të njëzetat, prandaj tani e mbante dhëndri. Por, megjithë fatkeqësitë, ajo nuk e kishte humbur pusullën. Kur erdhi ëmbëlsira, e piu me qejf një gotëz likerit të ëmbël dhe këndoi me vete:

Joyeux tambourins, menez la danse...³

Familja Brën, bashkë me të ftuarit, ndodhej në sallën e vogël të ngrënies, por të ndriçuar mirë. Mobiliet - një kredencë stil Henriku II, karrige kashte me shpinoren me kolonëza, një shezlong me cohë të zezë, qëndisur me lule të kuqe, një piano pas murit - ngjesheshin pas njëra-tjetrës, duke e shfrytëzuar me sa mundej hapësirën e ngushtë. Muret ishin zbukuruar me vizatime të blera në magazinat e mëdha të Luvrit dhe paraqisnin vajza që luanin me macet, barinj napolitanë (me Vezuvin në sfond), po edhe një riprodhim i *L'Abandonnée*, vepër mjaft mallëngjyese, ku shihej një grua shtatzënë e ulur në një ndenjësë prej mermeri që qante, në kohë vjeshte, ndërsa një husar i Armatës së Madhe largohej mes shtegut të mbuluar me gjethe të rëna.

Brënët banonin në zemër të një lagjeje shumë të populluar, jo larg Stacionit të Lionit. Fishkëllimat e gjata e të përmalluara të trenave mbërrinin deri tek ata, mbushur me thirrje që nuk i dëgjonte njeri. Por, ata e ndiqnin me vëmendje dridhjen e argjendit, ajrore, muzikore, që ngrihej herë pas here nga ura e metaltë, të cilën e përshkonte treni, kur, tek dilte nga thellësitë e nëndheshme, shfaqej për një çast nën qiell dhe pastaj nxitonte e zhdukej përsëri, me një rënkim të shurdhët. Sa herë kalonte, xhamet dridheshin.

Në ballkon, të mbyllura në kafaz, këndonin kanarinat; në një tjetër gugatnin turtulleshat. Nga poshtë ngrihej zhurma e së dielës: nga të gjitha katet, përmes dritareve të hapura, dëgjoheshin tringëllimat e gotave, të pjatave dhe nga rruga vinin britmat e gëzuara të fëmijëve. Muret e gurta e të hirta të shtëpive, përmytur në dritë, kuqëllohin. Deri edhe xhamat e dritareve të apartamenteve përkundruall, që gjatë gjithë dimrit nxiroshnin nga pluhuri e ndotja, tani e derdhnin dritën si ujë të bekuar. Aty ishte dhe qoshja ku shitësi i gështenjave të pjekura strukej e gjente pak ngrohje, që nga tetori e tutje; po tani ishte zhdukur dhe në vend të tij kishte mbirë një vajzë flokëkuqe që shiste manushaqe. Madje dhe ajo qoshe e zyrtë tani mbulohej nga një

³. Hapeni vallen, o dajre, plot hare... (shën. përkth. Të gjitha shënimet e mëtejshme janë të përkthyeses.)

tis i praruar: dielli shkëlqente kokrrizat e pluhurit, atë pluhurin që ngrihet në Paris në pranverë, në kohë të mirë dhe që duket sikur është prej pluhuri orizi dhe prej pjalmi lulësh (derisa nuk fillon e bie erë bajgë).

Ishte një e diel e bukur. Marsial Brëni solli ëmbëlsirën, një *moka*⁴ që ia ndriti sytë nga gëzimi të riut Bernard Zhakëlen kur e pa. E hëngrën tortën në heshtje dhe e vetmja zhurmë që ndihej ishte tiketakja e lugëve mbi pjata dhe kërkëllitja e kokrrave të kafesë mes dhëmbëve, mbytur me liker aromatik e të zhytura në krem. Pastaj, pas këtij çasti të përqendruar, rifilluan bisedën, qetësisht, pa ndonjë pasion, njësoj si gurgullima e çajnikut. Marsial Brëni, një djalosh njëzeteshtatëvjeçar që studionte për mjekësi, me hundë të gjatë e të mprehtë, me majën gjithnjë të përskuqur, me qafën e gjatë që e mbante përkulur në mënyrë qesharake, thujse po dëgjonte një të fshehtë dhe me sy të bukur si të kaprollit - tregoi për provimet që po afroheshin.

- Djemtë tanë duhet të lodhen ca, - tha Blanshë Zhakëleni dhe psherëtiu, duke vështruar të birin. E donte deri në atë pikë sa i rrëqethej zemra gjithë kohës; po të merrte vesh se në Paris kishte rënë tifoja, për shembull, e përfytyronte atë të sëmurë, madje dhe buzë vdekjes, po të dëgjonte muzikën e një regjimenti në marshim e mendonte me tmerr ushtar. I hodhi Marsial Brënit një shikim të trishtuar e të thellë, duke zëvendësuar tiparet e tij të zakonshme me ato të të birit, për sytë e saj një krijesë e denjë për t'u adhuruar dhe mendoi ditën kur do të dilte edhe ai nga një shkollë e madhe, mbuluar me dafina.

Marsiali rrëfeu me një ndjesi kënaqësie studimet e tij dhe netët e gjata pa gjumë. Ishte modest me të tepërt, por mjaftonin nja dy gllënjka verë për të filluar përnjëherësh të fliste papushim, po kryesisht për veten. Ndërsa vazhdonte e kapardisej me rrëfimin e tij, e mbante gishtin tregues tek jaka e lartë që e shtrëngonte, e frynte dhe gjoksin si gjel, e ashtu qëndroi, derisa u dëgjua zilja e derës së jashtme. Tereza deshi të ngrihej e të shkonte ta hapte, por i riu Bernard i doli përpara dhe u kthye pas pak, i shoqëruar nga një burrë i ri me mjekër, me trup të lartë e të bëshëm; ishte një shok i Marsialit, student në drejtësi: Raimond Detongu. Ky Raimond Detongu, që ishte gjithë gjallëri, që fliste rrjedhshëm, me zë të bukur prej baritoni dhe që kishte sukses të madh me gratë, i ngjallte zili Marsialit, po edhe admirim të trishtë. Sapo e pa, e qepi gojën dhe, me një lëvizje të shqetësuar, pastroi thërrimet e bukës përreth pjatës së tij.

- Po flisnim pikërisht për studimet tuaja, djelmosha, - tha Adolf Brëni. - E kuptove se çfarë të pret? - shtoi, duke iu drejtuar Bernardit.

Bernardi nuk foli, sepse si katërmbëdhjetëvjeçar që ishte, shoqëria e të rriturve e bënte akoma të druhej. Kishte veshur pantallona të shkurtra (« Por ky është viti i fundit... Shpejt do të bëhet djalë i rritur», thoshte e ëma me një ton të tillë në zë, që shprehte keqardhje dhe krenari në të njëjtën kohë). Pas kësaj darke të shijshme i skuqnin faqet dhe kravata i shkonte shtrembër. Ai e drejtonte me forcë dhe hidhte pas flokët e shpupuritur që i binin mbi ballë.

I ati tha me zë si shpellë:

4. Ëmbëlsirë me bazë brumi e me krem me gjalpë të aromatizuar me kokrra kafeje.

- Të mbarojë njëherë Politeknikun me nota të larta. Ç'nuk kam bërë që ai të studiojë, kam marrë mësuesit më të mirë privatë dhe të tjerë, si puna e tyre; ai e di mirë se çfarë pres prej tij: e di mirë se duhet të kapë më të lartën, por, ama, peshkop është, i pari i klasës është.

Të gjithë u kthyen e shikuan Bernardin; atij ia pushtoi zemrën një valë krenarie. Ishte një ndjenjë e këndshme; pothuajse e papërballueshme. U skuq edhe më shumë dhe tha me atë zërin e tij, ende të ndryshueshëm, herë të mprehtë, sikur e nxirrte me zor e herë të ëmbël e të ulët:

- Ah, po s'është asgjë që...

Ngriti mjekrën me një lëvizje krenare, sikur të donte të thoshte: - Ta shihni se çfarë do të ndodhë! - dhe tërhoqi nyjen e kravatës kaq fort, sa gati e shqeu. Në mendje i dilte një pamje që e turbullonte e ku e shihte veten inxhinier të madh, matematicien, shpikës ose edhe zbulues botësh të reja, apo ushtar, i rrethuar nga një turmë grash vezulluese, miqsh të dashur e nxënësish.

Ndërkohë kullufiste copën e fundit të ëmbëlsirës që i kishte mbetur në pjatë dhe pyeste veten se si mundi ta hante, me gjithë ata palë sy të ngulur përmbi të; për fat të mirë i ati iu drejtua Marsialit, duke e shkarkuar tensionin prej tij dhe duke e lënë në hije, tashmë. Përfitoi dhe e hëngri me një kafshatë copën e mbetur të *mokës*.

- Në cilën degë të mjekësisë keni ndërmend të specializoheni? - e pyeti Marsialin zoti Zhakëlen. Zoti Zhakëlen vuante nga një sëmundje e tmerrshme në stomak; mustaqet i kishte të verdha, ngjyrë fieri të zbërdhulur dhe fytyra i ngjante si rërë ngjyrë hiri. Lëkura e saj i përshkohej nga rrudha që e bënë të ngjante si një dunë e gërryer nga puhia e detit. E vështronte Marsialin me një etje dhe pikëllim të tillë, sikur i vetmi fakt që po fliste me një mjek të ardhshëm përbënte një mundësi shëruese, por që, megjithatë, nuk mundej dot të gëzohej. Me një lëvizje mekanike, çoi dorën atje ku e grinte dhimbja, poshtë gjoksit të bërë gropë dhe tha:

- Sa keq që nuk jeni diplomuar akoma, miku im i dashur e i ri. Sa keq, vërtet. Do t'iu kisha kërkuar një mendim. Ah, sa keq...

Dhe qëndroi ashtu, i zhytur në mendimet e tij të hidhura.

- Pas dy vjetësh..., - tha me drojë Marsiali.

I nxitur nga pyetjet, ai tha se i kishte vënë syrin një apartamenti në rrugën Monge. Një mjek që njihnte dhe që donte të dilte në pension, mund t'ia lëshonte. E, ndërsa po fliste, përfytyroi me ëndje vargun e ditëve që e prisnin...

- Duhet të martohesh, Marsial, - i tha zonja e vjetër Pen, me një buzëqeshje ngacmuese.

Marsiali rrotulloi me acarim një toptë buke mes gishtërinjve, e shtroi dhe i dha formën e një njeriu, e shtypi me inat me pirunin e ëmbëlsirës dhe pastaj, duke i ngritur sytë e tij si të drerit mbi Terezën, tha me zë të mbytur:

- Po e mendoj. Kini besim, po e mendoj vërtet.

Tereza pati vetëtimthi një parandjenjë se ai e kishte fjalën për të; i erdhi për të qeshur dhe, në të njëjtën kohë, u ndje keq, sikur dikush ta kishte zhveshur lakuriq përpara të tjerëve. Pra, ishte e vërtetë ajo që thoshte i ati, gjyshja dhe shoqet e saj në kolegji: qëkur kishte mbledhur flokët, dukej si grua! Por, të martohesh me këtë Marsialin e urtë... E vështroi me kureshtje përmes qepallave të ulura. E njihnte qëkur ishin të

vegjël dhe e donte shumë; ajo do të jetonte me të njësoj siç kishin jetuar e ëma dhe i ati, deri ditën kur gruaja e re kishte vdekur. «I gjori djalë», mendoi, «është jetim». Zemra iu mbush me dhimbsuri dhe me përkujdesje ndaj tij. «Por, nuk është fare i bukur», tha me vete. «I ngjan asaj lamës te Kopshti Botanik. Ka dhe këtë pamjen e butë e sikur i ka ngelur hatri».